

**ZAMIRA BOBOLI**

**STRUKTURA GRAMATIKORE E GJUHËS DHE METODAT  
E TË NXËNIT TË ANGLISHTES NGA NXËNËSIT SHQIPFOLËS**

Gjuha është faktori kryesor për shprehjen e perceptimit, ndjenjës, mendimit dhe gjykimit. Mësimi, kultivimi dhe zhvillimi i saj nuk duhet të nënkuptohet vetëm si nevojë apo si mjet ndërkomunikimi, orientimi e veprimi, por edhe si faktor themelor për zhvillimin e kompetencës së duhur gjuhësore, të formimit të personalitetit, të vetëdijes dhe të identitetit kulturor e social<sup>1</sup>. Duke u nisur nga kjo qasje duhet të theksojmë faktin se gjatë mëimit të gjuhës së huaj kushdo e ka të domosdoshme të marrë njohuritë e duhura që lidhen me aspektin e strukturave gramatikore të gjuhës së huaj. Sa herë që një mësimdhënës mëton të realizojë objektivin e tij final që nënkupton përcjelljen të nxënësi të informacionit të plotë gjuhësor dhe si rrjedhojë nxënësi ka përvetësuar shprehësinë e përdorimit të gjuhës së huaj gjatë komunikimit, ai gjithashtu synon të ofrojë të nxënësi një gamë të gjerë të rregullave gramatikore, të cilat janë thelbësore gjatë fazave fillestare të mëimit të gjuhës së huaj. Një pranëvënie dhe përjasje e strukturave të gjuhës angleze me gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe e lehtësojnë procesin e përvetësimit të nxënësi dhe në të njëjtën kohë e orientojnë mësuesin drejt rezultateve të duhura në fazat e mëvonshme.

Gjuha realizohet përmes strukturave gramatikore (morfologjia dhe sintaksa). Gramatika e një gjuhe ekziston pavarësisht nëse ne që flasim këtë gjuhë e vërejmë atë apo jo. Gjuha është një grumbull rregullash të cilët veprojnë mbi ndryshimin e fjalëve dhe mbi bashkimin e tyre në fjali. Bashkimi i fjalëve në fjali nuk realizohet përmes një kombinimi arbitrar të tyre, por sipas një sistemi rregullator që ka çdo gjuhë<sup>2</sup>.

Mësimi i gjuhës së dytë është një proces mjaft kompleks dhe i gjerë. Shumë njerëz kanë përjetuar procesin e mëimit dhe përdorimit në praktikë të një gjuhe të huaj, por i gjithë ky proces i nxënies përmban disa elementë

---

<sup>1</sup> M. Mustafa, *CH-St. Gallen: Albanischen Institut*, dhjetor, 2008, f. 422.

<sup>2</sup> R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, ShBLU, Tiranë, 2008, f. 75.

përbërës që shpjegojnë në mënyrë të hollësishme se si ndodh ky proces i nxënies<sup>3</sup>. Në varësi të kushteve ku një individ është përpjekur të mësojë një gjuhë të huaj apo e kanë detyruar rrethanat ta përvetësojë atë, ai ende nuk e ka të qartë se cili është mekanizmi apo aktiviteti që ka rezultuar më shumë i frytshëm për të.

Nga ana praktike një person mund të ketë kuptuar e përvetësuar më së miri disa strategji dhe aktivitete që e kanë ndihmuar ose penguar atë gjatë përvetësimit të gjuhës, por nga ana tjetër nuk është në dijeni të gjithë faktorëve që veprojnë në nivelin e nxënies apo mësimdhënies. Gjuhëtarët tradicionalisht e kanë parë gjuhën si një sistem kompleks i komunikimit, i cili duhet të analizohet në një sërë nivelesh gjuhësore: fonologji, morfologji, semantikë, leksik, pragmatikë dhe ligjërim. Qasjet e ndryshme dallojnë në lidhje me rëndësinë që ka secili nivel, ndërthurja mes tyre apo analiza e tyre në mënyrë të mëvetësishme. Prioritetin që ka njëri apo tjetri nivel në mësimin e gjuhës, sintaksa dhe morfologjia janë parë si thelbësore në mësimin e gjuhës dhe shumica e teorive përqendrohen në zhvillime të spikatura në këto rrafsh të gjuhës<sup>4</sup>. Është mjaft e rëndësishme përcjellja te nxënësi i tipareve dhe veçantive që gjuha e huaj mund të shpërfaqë gjatë përdorimit në ligjërime të ndryshme, e parë kjo në kuadrin e lëmit përjasës dhe krahasues me strukturat gramatikore të gjuhës shqipe. Nëse nxënësi ka përvetësuar qartë strukturat gramatikore të gjuhës së tij amtare, atëherë ai e ka shumë të lehtë formulimin e fjalive dhe strukturave të tyre, si dhe përdorimin e tyre në tekste edhe më të plota në gjuhë.

Përvetësimi i gramatikës në mësimin e një gjuhe konsolidon te nxënësi njohuri të sakta gramatikore, përkapjen e anës kuptimore apo rritjen e shprehësisë në gjuhë të huaj. Kjo rrit shkallën e motivimit te nxënësi dhe aftësia e tyre komunikuese kapërcen kufijtë që dikton teksti, metodat e përdorura dhe konteksti social në të cilin komunikojnë. Nxënësi fiton aftësinë për ta zgjeruar objektin e ligjërimin edhe në nivele më të larta. Një fjali e ndërtuar saktë nga ana gramatikore mundëson vijimësinë e ligjërimin përkatës dhe rrit shkallën e vetbesimit dhe motivimin te folësi (nxënësi) për të marrë pjesë në bisedë dhe kjo shërben si një test i përvetësimit.

Gjuha shqipe dhe gjuha angleze bëjnë pjesë në familjen e gjuhëve indoeuropiane pra, në një familje gjuhësh me burim të përbashkët. Gjatë

<sup>3</sup> R. Mitchell, F. Myles, *Second language learning theories*, Arnold publication, 2004, f. 6.

<sup>4</sup> *Po aty*, f. 10.

evolucionit, gjuhët indoeuropiane kanë pësuar ndryshime të mëdha, në të cilat të gjitha nënsistemet e tyre janë larguar shumë njëra nga tjetra. Disa prej tyre mbijetojnë si gjuhë me tipare të veçanta si p.sh shqipja. Por, ka dhe grupe gjuhësh, si grupi i gjuhëve gjermanike (anglishtja, gjermanishtja, norvegjishtja etj.), të cilat janë zhvilluar nga gjermanishtja e vjetër.

Si rrjedhim i evolucionit të saj historik shqipja ashtu si shumë gjuhë të tjera indoeuropiane është shndërruar në një gjuhë sintetike-analitike, duke u larguar nga tipi i hershëm i gjuhëve indoeuropiane, të cilat mendoheshin të ishin gjuhë sintetike. Humbja e eptimit dhe ngulitja e rendit të gjymtyrëve në fjali i kanë dhënë shkas një ndryshimi të rëndësishëm në tipin e gjuhëve. Pra, gjuhët janë shndërruar nga një tip sintetik në një tip sintetik-analitik (shqipja) ose në një tip analitik-sintetik (anglishtja).

Anglishtja si një gjuhë analitike-sintetike karakterizohet nga një rend i ngulitur i fjalëve në fjali dhe si rrjedhojë ligjërimit në anglisht bazohet në një strukturë bazë të tillë si: S-V-O. *The teacher explains the lesson.* (*Mësuesi shpjegon mësimin.*)

Gjuha shqipe, në të kundërt, është thënë se ka një rend të lirë të fjalëve në fjali dhe gjymtyrët mund të lëvizin në pozicione të ndryshme duke mos prekur semantikën e fjalisë. Gjuha shqipe është një gjuhë flektive, kurse anglishtja e ka humbur fleksionin dhe si rrjedhojë këto dy gjuhë shfaqin ndryshime të dukshme në sistemet e tyre gramatikore. Duke qenë e tillë, gjuha shqipe përdor mjete morfologjike për të shprehur funksione të ndryshme sintaksore, ndërsa anglishtja si një gjuhë joflektive përdor mjete të tjera për të shprehur këto funksione. Duke qenë se shqipja dhe anglishtja u përkasin tipeve të ndryshme gjuhësh, atëherë do të vërenim ndryshime të dukshme në rrafshin morfologjik, sintaksor dhe leksikor.

E parë në aspektin e gjuhësisë gjenerative, mund të veçojmë faktin se gramatika universale është një sistem i hapur që ka edhe veçori që nuk janë të lindura, si p.sh. parametrat<sup>5</sup>. Siç kanë përmendur edhe studiues të tjerë, shprehja e *Pro* është një parametër. Ky parametër ka dy vlera: kryefjala zero (gjuha në të cilën fjalitë mund të mos kenë kryefjalë të shprehur); me kryefjalë (gjuhët në të cilat kryefjala duhet të shprehet në fjali në mënyrë që fjalia të jetë e saktë nga ana gramatikore). Për shembull fjalia; *want more apples* nuk është e saktë nga ana gramatikore në gjuhën

---

<sup>5</sup> J. Mita, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Pishtinë 2005, f. 131-133.

angleze, por është e saktë në gjuhën italiane dhe spanjolle. Pra, gjuha italiane është një gjuhë ku vepron parametri i kryefjalës zero, ndërsa gjuha angleze është një gjuhë ku kryefjala është e detyruar të shprehet në fjali<sup>6</sup>. Shprehjen e përemrit kryefjalë e dallojmë në gjuhët analitike si anglishtja, por nuk e ndeshim te gjuha shqipe si një gjuhë sintetike.

Të gjitha tiparet e strukturave gramatikore të dy gjuhëve gjejnë përdorim gjatë procesit të mësimdhënies dhe përvetësimit të këtyre njohurive nga ana e nxënësve shqipfolës. Metodologjia dhe metodat e përdorura gjatë orës së mësimt janë të larmishme dhe lidhen në mënyrë direkte me përmbajtjen e mësimt dhe objektivat që mësuesi përcakton paraprakisht për të përmbushur. Qëllimi i mësuesit është përvetësimi i duhur i lëndës dhe përdorimi praktik i gjuhës së huaj në dialogë, ese, bashkëbisedime, situata konkrete nga ligjërimi i përditshëm.

Një nga qasjet e viteve të fundit është vështrimi konstruktivist ndaj mësimdhënies në përgjithësi dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në veçanti. Një nxënës i kohëve të sotme ka si synim të përvetësojë dhe demonstrojë aftësitë e tij komunikuese në mënyrën e duhur dhe e ndërtuar saktë nga ana kuptimore. Pra, një nxënës i gjuhës së huaj duhet të jetë i aftë të shprehë të menduarit e tij kritik për ta aplikuar njohurinë tij mbi gjuhën në një gamë të larmishme situatash. Por, për t'i nxituar ata të jenë komunikues të mirë dhe të fitojnë shprehitë e duhura në gjuhën e huaj, mësuesi duhet të sigurojë të gjitha kushtet e nevojshme për të arritur objektivat. E kufizuar vetëm në ambientet e klasës, mësimdhënia nuk mund të ndihmojë plotësisht një nxënës shqipfolës në përdorimin praktik të gjuhës angleze.

Përdorimi i konstruktivizmit (*constructivism approach*) si një strategji e re në orën e mësimt ndërthur në mënyrë të pashmangshme aspektin teorik, informativ dhe njohës me anën praktike, pra përdorimin e teknologjisë në orën e mësimt. E vendosur përballë qasjeve tradicionale të modelit tradicional të transmetimit të informacionit te nxënësi (në të cilën mësuesi shpjegon, transmeton dhe informon nxënësin duke lënë mënjanë anën praktike dhe domethënien e përmbajtjes), strategjia e konstruktivizmit ka një ndikim të madh në fushën e edukimit. Nxënësi në orën e mësimt është një pjesëmarrës aktiv i procesit të të nxënës, ai ndërvepron dhe bashkëpunon me shokët e tij dhe mësuesin, gjë që përbën ambientin fizik që vetë mësuesi ndërton. Ndërsa, hapi tjetër qëndron në krijimin e situatave ku paraqitet zgjidhja e problemeve dhe aftësitë e të menduarit kritik. Strategjia e konstruktivizmit mëton të ndërtojë në mënyrë

---

<sup>6</sup> D. W. Carroll, *Psychology of language*, Thomson-Wadsworth, 2004, f. 42.

aktive procesin e përvetësimit të njohurive kundrejt procesit pasiv të nxënies së tyre. Ja një rast i përdorimit të suksesshëm të konstruktivizmit në një të gjuhës së huaj:

*Present progressive tense*, është një kohë e tashme e cila nuk ka gjegjëse të drejtpërdrejtë në gjuhën shqipe. Ajo mund të emërtohet në shqip si koha e tashme me aspekt të vazhduar. Në gjuhët e familjes indoevropiane kundërvëniet kohore ndërthuren edhe me dallime aspektore. Në ato që nuk e kanë aspektin si dukuri të veçantë, disa vlera aspektore shprehen me mjete leksikore, si në shqipen, ku dallimi i veprimit të caktuar nga ai i pacaktuar shprehet me pjesëzën *po*: *te po punoj*, pjesëza *po* tregon se nuk është fjala për veprimin e të punuarit në përgjithësi, por për një veprim konkret që ndodh në çastin që flasim. Një kuptim të njëjtë kanë në anglishte kohët e vazhduara: *I am working*<sup>7</sup>. Me anën e strategjisë konstruktiviste mësuesi e transmeton njohurinë mbi këtë kohë (pra, për të përcjellë te nxënësi vlerën aspektore të shenjuar nga folja) në këtë mënyrë: *I am drawing an apple* duke e shoqëruar fjalinë me veprimin përkatës apo fjalitë e tjera si për shembull *I am opening the door*, *I am walking*, etj., duke ndjekur po të njëjtën procedurë: citim i fjalisë në gjuhën angleze - shoqërimi me veprim përkatës. Për të përforcuar dhe më tepër kohën e kryerjes së veprimit mësuesi mund ti pyesë nxënësit: *When am I drawing?* dhe nxënësit përgjigjen njëzëri: *Now* apo *right now* për të vënë në dukje kohën se kur ndodh veprimi.

Ja disa prej metodave që ne mendojmë janë metodat e duhura në arritjen e objektivave të synuara gjatë orës së mësimit:

*Metoda Audolinguale*: Kjo metodë bazohet në parimin e psikologjisë bihevioriste ku informacioni paraqitet në formën e dialogut bazuar mbi parimin se mësimi i një gjuhe është i ngjashëm me mësimin e një sjelljeje ku kuptueshmëria varet nga mimika, memorizimi i frazave dhe mësimi i frazave njëra pas tjetrës. Në këtë metodë gjithçka përsëritet disa herë pa shpjegime gramatikore të drejtpërdrejta dhe shpeshherë përdoret krahasimi midis gjuhës nënë dhe gjuhës angleze.

P.sh.:

- tomorrow
- in the restaurant tomorrow
- will be eating in the restaurant tomorrow
- Those boys will be eating in the restaurant tomorrow.

---

<sup>7</sup> R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria 2004, f. 240.

*Metoda e përkthimit gramatikor:* kjo metodë fillimisht u përdor në mësimin e gjuhës greke dhe latine dhe më pas u përgjithësua dhe në mësimin e gjuhëve të tjera. Mësimi shpjegohet në gjuhën nënë dhe përdorimi i gjuhës angleze është shumë i vogël. Fjalori mësohet si një listë fjalësh të izoluar dhe e vetmja mënyrë për të kontrolluar njohuritë e marra është nëpërmjet përkthimit të fjalive të ndryshme të shkëputura nga tekstet duke mos i kushtuar rëndësi shqiptimit të fjalëve.

*Metoda e drejtpërdrejtë:* kjo metodë u zhvillua fillimisht si një përprjekje për të përmirësuar metodën e përkthimit gramatikor. Mësimi fillon me një dialog në gjuhën angleze dhe çdo material me fjalë, veprime apo dhe piktura e foto. Në këtë metodë nuk lejohet përdorimi i gjuhës nënë dhe as përkthimi. Çdo pyetje bëhet në gjuhën angleze dhe gramatika mësohet në mënyrë induktive duke u përgjithësuar nga praktika dhe eksperiencia në gjuhën angleze.

*Metoda e leximit:* zakonisht kjo metodë përzgjidhet për arsye akademike siç mund të jenë studimet universitare apo dhe studime të ndryshme shkencore. Përdoret përgjithësisht për studiuesit që kanë si synim vetëm përforcimin e aftësisë së të lexuarit në gjuhën angleze si dhe të dhëna kulturore e historike të vendit ku ajo përdoret. Kjo metodë kërkon përdorimin e gramatikës së nevojshme për lexim si dhe pasurimin e fjalorit me terma të ndryshëm shkencorë. I kushtohet pak ose aspak rëndësi shqiptimit apo aftësive komunikuese. Përkthimi përdoret si një procedurë e nevojshme për kuptimin e tekstit të shkruar.

*Metoda e komunikimit:* kjo metodë synon rritjen e shkallës së aftësive komunikuese si dhe kalimin nga kompetencë gjuhësore në kompetencë komunikuese. Gjatë përdorimit të kësaj metode nxënësit lejohen të përdorin të dyja gjuhët, mësuesi nuk korrigjon të gjitha gabimet menjëherë, si dhe ai përpiqet të krijojë një ambient jo stresues apo gjykues në klasë. Mësimi fokusohet në përcjelljen e mesazhit dhe ndërveprimin midis nxënësve.

*Metoda nocionore funksionale*<sup>8</sup>: Kjo metodë synon copëzimin global të gjuhës në njësi më të vogla analitike sipas situatave që ato përdoren. Nocionet trajtohen si elementë kuptimorë që mund të shprehen me anë të emrave, përemrave, foljeve, parafjalëve, lidhëzave,, mbiemrave apo foljeve të cilët varen nga a) funksionet, b) elementët në situatë dhe c) çështja që diskutohet.

---

<sup>8</sup> M. Finocchiaro & C. Brumfit (1983). *The Functional-Notional Approach*. New York, NY: Oxford University Press.

*Metoda e përgjigjes tërësisht trupore*<sup>9</sup>: kjo metodë përkufizohet si metoda që përshtat informacionin dhe aftësitë nëpërmjet sistemit ndjesor kinestetik. Ky kombinim i lejon nxënësit të përthithin si informacionin dhe aftësitë me shumë shpejtësi. Si pasojë kjo metodë sjell një motivim të madh tek studentët. Synimet e saj janë: kuptimi i gjuhës së folur para praktikimit të saj, përdorimi i mënyrës urdhërore si në komunikim ashtu edhe në transferimin e njohurive si dhe mosdetyrimi i nxënësit të flasë atëherë kur nuk është gati. Disa hapa që ndiqen në këtë metodë janë:

- mësuesi jep urdhrin dhe kryen veprimin;
- mësuesi jep urdhrin dhe së bashku me nxënësin kryejnë veprimin;
- mësuesi jep urdhrin, por vetëm nxënësi kryen veprimin etj.

*Metoda e heshtur*: kjo metodë fillon me përdorimin e disa shkopinjve me ngjyrë dhe dhënie urdhrash për të krijuar situata të ndryshme gjuhësore që kontrollohen tërësisht nga mësuesi.

Përgjithësisht këto janë disa nga metodat kryesore që janë përdorur në rrjedhën e kohës për mësimin e gjuhës angleze por nuk janë të vetmet. Ajo që vlen të theksohet është që nuk mund të flasim në terma “metodë e mirë” apo “metodë e gabuar”. Mësuesi bashkëkohor i gjuhës angleze duhet të dijë tu përshtatet kërkesave dhe pritshmërive të nxënësve të tij duke përdorur, pse jo, dhe një ndërthurje të këtyre metodave për të qenë sa më i suksesshëm dhe të ketë rezultate të kënaqshme në punën e tij. Ndërthurja e metodave, teknikave dhe strategjive bashkëkohore në mësimdhënie dhe vënien në dukje të rëndësishme që ka përvetësimi i gramatikës së një gjuhe të huaj e orientojnë mësuesin drejt realizimit të objektivave që ai synon dhe nxënësin drejt një përvetësimi të thellë të njohurive të marra.

## **BIBLIOGRAFI**

- Asher, J.C. (1979). *Learning Another Language Through Actions*. San Jose, California: AccuPrint.
- Carroll, D. W., *Psychology of language*, Thomson-Wadsworth, 2004.
- Finocchiaro, M. & Brumfit, C. (1983). *The Functional-Notional Approach*. New York, NY: Oxford University Press.
- Memushaj, R., *Gjuhësia gjenerative*, ShBLU, Tiranë, 2008.
- Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Dituria 2004.

---

<sup>9</sup> J. C. Asher, (1979) *Learning another language through actions*. SanJose, California: AccuPrint.

- Mita, J., *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Pishtinë, 2005.
- Mustafa, M., *CH-St. Gallen: Albanischen Institut*, dhjetor, 2008.
- Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G., Svartvik, J., *Comprehensive Grammar of the English Language* (General Grammar) 1st Edition  
ISBN-13: 978-0582517349, 1989.
- Richards, J. C., Rodgers, Th. S., *Approaches and Methods in Language Teaching* (Cambridge Language Teaching Library) 3rd Edition  
ISBN-13: 978-1107675964, 2014.